

13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 537/1 Prot.

Tiranë, më 03/06/2015

Lënda: Dërgohet Vendimi nr. 85, datë 03/06/2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi çështjen “*ex-officio*” të përfitimit të ndihmës ekonomike, nga ana e banorëve të njërive të pushtetit vendor (komuna)

Drejtuar: Znj. [Emri i personit]
Drejtores e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 83, Tiranë.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr. 85, datë 03/06/2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi çështjen “*ex-officio*” të përfitimit të ndihmës ekonomike, nga ana e banorëve të njërive të pushtetit vendor (komuna)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 85, Datë 03/06/2015

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji", nenin 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara" dhe bazuar në informacionin e grumbulluar nga shqyrtimi i disa ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Komunën Grabian Lushnje, me urdhërin nr. 46 , datë 24.05.2013, urdhëroi fillimin e procedurave për ndjekjen "ex-officio" të çështjes së përfitimit të ndihmës ekonomike, nga ana e banorëve të njësive të pushtetit vendor (komuna). Në analizë të informacionit të grumbulluar gjatë shqyrtimit administrativ:

K O N S T A T O N :

Bazuar në shqyrtimin e disa ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Komunën Grabian Lushnje u evidentua se, banorët e kësaj komune nuk përfitonin ndihmë ekonomike, me pretendimin se përfshihen në kategorinë e njësive vendore të cilat janë të pajisura me tokë.

Referuar ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", njësitë e qeverisjes vendore, kanë detyrim ligjor të mbështesin me ndihmë ekonomike apo forma të tjera ndihme, familjet në nevojë me qëllim zbutjen e varfërisë.

Mbështetur në informacionin e sipërcituar dhe në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji", Komisioneri nisi procedurat për shqyrtimin ex-officio të çështjes.



Në zbatim të nenit 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Më datën 27.05.2014, me shkresën nr. 329/1 Prot., është bërë njoftimi i znj. [] ish-Drejtores e Shërbimit Social Shtetëror, si dhe u kërkua të administrohej informacion, në lidhje me shqyrtimin e çështjes ex-officio, të iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nëpërmjet shkresës nr. 756/1 prot., datë 06.06.2013, Sektori i Programit të Zhvillimit, pranë Shërbimit Social Shtetëror, informoi Komisionerin se: "Në mbështetje të Ligjit Organik të buxhetit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", si dhe ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe mbrojtjen shoqërore", Shërbimi Social Shtetëror, ka vlerësuar treguesit e ardhur nga njësitë vendore sipas modulit të miratuar, ka bërë programimin e fondeve, për skemën e Mbrojtjes Sociale, e cila shërben për çeljen e fondeve për vitin 2013 si dhe gjatë vitit, ku dhe i është propozuar Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratimin e fondeve në tërësi dhe mbrojtjen sociale në veçanti. Fondet e akorduara për bllokndihmën ekonomike **për Komunën Grabian:**

Për vitin 2012, rezultojnë 85.000 lekë, fonde këto të çelura nga SHSSH me kërkesë të Zyrës Rajonale Fier, për dy fëmijë të pajisur me statusin e jetimit, pasi vetë njësia vendore nuk ka kërkuar fonde jo vetëm për familjet e skemës së ndihmës, por as edhe kategoritë të cilat janë pajisur me statuset përkatëse, si fëmijët jetim, 3-4-5 njakë etj.

Për vitin 2013, rezultojnë 85.000 lekë, fonde këto të programuara nga SHSSH, në bazë të modulit të miratuar si dhe në bazë të kërkesës së Zyrës Rajonale Fier, për 2 fëmijë jetim, ndërsa të dhënat e tjera nga njësia vendore janë të pa plotësuara, e për rrjedhojë nuk kemi si të planifikojmë fonde për ndihmën ekonomike."

- Duke qënë se Komisioneri kishte në objekt të shqyrtimit të çështjes jo vetëm Komunën Grabian por njësitë vendore të Republikës së Shqipërisë, me anë të shkresës nr. 356, datë 14.06.2014, i kërkoi z. [] ish-Drejtor i Shërbimit Social Shtetëror, informacion shtesë lidhur me të gjithë njësitë vendore (komuna), të Republikës së Shqipërisë. Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, Shërbimi Social Shtetëror nuk vuri në dijeni asnjë informacion shtesë, për shqyrtimin e çështjes.



- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 62, datë 28.01.2014, i kërkoi sërish Shërbimit Social Shtetëror, informacion lidhur me kërkesat e administratorëve shoqëror të njësive vendore (komuna), për fonde të bllokndihmës ekonomike.

Shërbimi Social Shtetëror, në përgjigje të shkresës së Komisionerit, informoi se: *“E njëjta situatë paraqitet sërish edhe për vitin 2014, në Komunën Grabian, ku për periudhën Janar-Shkurt 2014, kësaj njësie vendore i është akorduar një fond prej 20.000 lekë, bazuar kjo sipas modulit 1, të plotësuar nga vetë njësia vendore dhe me kërkesë të Zyrës Rajonale Fier. Nuk është Shërbimi Social Shtetëror, institucioni që njeh situatën sociale të njësisë vendore, por vetë njësia vendore që plotëson të dhënat dhe më pas Shërbimi Social programon fondet.”*

Komisioneri duke vlerësuar në tërësi të gjitha rrethanat dhe provat e administruara,

VËREN:

Gjatë aktivitetit “Ditë të hapura”, të organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të implementimit të Projekteve të OSCE/ODHIR, në Komunën Grabian, Lushnje, referuar informacionit të administruar, banorët e Komunës Grabian, nuk përfitonin ndihmë ekonomike nga ana e kësaj njësie vendore. Pas informacionit të shkëmbyer me njësinë vendore, u konstatua se në Komunën Grabian, Lushnje, nuk përfitonte asnjë banorë nga bllokndihma ekonomike, me arsyetimin se përfshihen në kategorinë e njësive vendore të cilat janë të pajisur me tokë, për këtë arsye, nuk mund të përfitojnë ndihmë ekonomike.

Referuar informacionit të sipërcituar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerësoi të pabazuar në legjislacion arsyetimin dhe veprimet e ndërmarra nga ana e Komunës Grabian, për të mospërfshirë banorët në skemën e ndihmës ekonomike dhe për këtë arsye Komisioneri rekomandoi marrjen e të gjitha masave të menjëhershme nga ana e Këshillit të Komunës Grabian dhe të Komunës Grabian, që të trajtojë me përparësi familjet në nevojë me qëllim zbutjen e varfërisë.

Nga informacioni i administruar nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u konstatua se për vitin 2012, njësitë vendore: Komuna Topojë, Komuna Mbrostar dhe Komuna Grabian, ishin të vetmet të cilat nuk kishin përfshirë në bllokndihmë ekonomike, banorët e tyre. Gjithashtu për vitin 2013 dhe 2014, është konstatuar e njëjta situatë në komunat: Topojë, Allkaj, Grabian dhe Terbuf.

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, njësitë vendore të sipërcituara, nuk kanë kërkuar përfshirjen në bllokndihmën ekonomike të banorëve të tyre. Duke shqyrtuar një nga një këto njësi administrative vërejmë se:



- Komuna Topojë, për vitet 2012-2013-2014, megjithëse është një njësi administrative me 7476 banorë dhe 1661 familje, nuk ka kërkuar asnjë herë në këtë periudhë përfshirjen në bllokndihmën ekonomike të banorëve të tyre. Rezulton që në këtë njësi vendore, nuk ka asnjë familje apo banorë që përfiton nga bllokndihma ekonomike apo ndihma të tjera sociale (statusi i jetimit, invalidit etj.)
- Komuna Allkaj, me 6120 banorë dhe 1380 familje, për vitet 2012-2013-2014, ka kërkuar vetëm fonde për banorë të cilët përfitojnë nga statusi i jetimit, por nuk ka kërkuar asnjë herë në këtë periudhë përfshirjen në bllokndihmën ekonomike të pjesës tjetër të familjeve.
- Komuna Grabian, me 6900 banorë dhe 1550 familje, siç është cituar edhe më lart, ka bërë kërkesë për fonde, vetëm për 2 fëmijë të cilët përfitojnë nga statusi i jetimit, ndrsa për pjesën tjetër të banorëve, nuk ka kërkuar fonde për ndihmë ekonomike.
- Komuna Terbuf, me 16500 banorë dhe 3850 familje, ka bërë kërkesë për fonde, vetëm për një familje, ku në përbërje të saj janë 3 fëmijë të cilët përfitojnë nga statusi i jetimit, ndrsa për pjesën tjetër të banorëve, nuk ka kërkuar fonde për ndihmë ekonomike.

Sipas nenit 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 *“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, ku citohet se: *“Përfitues të ndihmës ekonomike janë familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme”*, familjet e njërive vendore të sipërcituara, të cilat nuk kanë të ardhura ose të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat jetike, nuk përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike.

Nga skema e ndihmës ekonomike nuk përjashtohen as familjet që janë të pajisura me tokë, nëse kanë të ardhura të pamjaftueshme nga toka, bagëtia, shpendët, vreshtaria, kopshtaria etj, pasi bazuar në nenin 19 , pika 2 të ligjit të sipërcituar: *“Ndhma ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga toka, bagëtia, shpendët, vreshtaria e kopshtaria, pensionet dhe të ardhura të tjera”*.

Në nenin 29, pika 1, të këtij ligji parashikohet se: *“Këshilli i bashkisë/komunës ka përgjegjësi të miratojë fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike”* dhe pika 2 e këtij neni citon: *“Këshilli i bashkisë/komunës ka përgjegjësi që me fondet e veta, në bazë të kriterëve specifikë, mbështet me ndihmë ekonomike, apo forma të tjera ndihme të menjëhershme, familjet e varfra”*.

Duke analizuar përse më lart, njësitë vendore kanë detyrim ligjor që të mbështesin me ndihmë ekonomike familjet në nevojë dhe ato të varfra. Fakti që këto familje mund të jenë të pajisura me tokë, nuk e përjashton përgjegjësinë e asnjë prej njësive vendore që të mbështesin me ndihmë ekonomike apo forma të tjera ndihme banorët e saj. Gjithashtu Këshilli i njësive vendore duhet të kishte marrë masa që familjet në nevojë, të ishin trajtuar me ndihmë ekonomike.

Referuar në kreun XI, pika 9 e udhëzimit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 338/3, datë 10.03.2006 Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, citohet: “Drejtoria rajonale organizon takime, seminare si dhe organizon kualifikimin personal të administratorëve pranë seksioneve të ndihmës ekonomike në bashki a komunë”, si dhe në pikën 10 ku parashikohet: “Administratorët e seksionit të ndihmës dhe të përkujdesit në bashki/komuna janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit, si dhe raportojnë përpara këshillit të komunës, si dhe kryetarit të bashkisë/komunës”. Administratorët e seksionit të ndihmës ekonomike pranë njësive vendore, bazuar më lart, duhet të kishin marrë masa që banorëve t’u krijohej mundësia e përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike.

Njësitë vendore, në kompetencat e përbashkëta me pushtetin qendror, kanë detyrim kujdesin social dhe zbutjen e varfërisë, bazuar në nenin 11, pika 3/c e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku sanksionohet se: “Komunat duhet të ndër marrin bashkëpunim me pushtetin qendror për kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse”

Në nenin 3, pika 1 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, citohet: “Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”.

Gjithashtu në nenin 3, pika 3, parashikohet: “Diskriminimi i tërthortë është ajo formë diskriminimi kur ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person apo grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjestim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.